



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2771/11 prot.

Datë 20.12.2023

V E N D I M
Nr. 1334/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rikon - AI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82700-10-09-2023, me objekt: “Blerje materiale kompjuterike”, me fond limit 3,477,567 (tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Sinteza Co” SHPK me NIPT K11324003F dhe adresë: Rruga e Barrikadave, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime, Qarku Shkodër SH.A. Lagjja 3 Heronjtë, Rruga “Marin Biçikemi”, Shkodër.
- Subjekte të Interesuara:** “Rikon - AI” SHPK me NIPT L22119010H dhe adresë: Njësia Administrative Kashar, Rruga “Ismail Qemali”, ND.40, H. 28, 1050, Yzberisht, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82700-10-09-2023 me objekt: “Blerje materiale kompjuterike”, me fond limit 3,477,567. lekë pa TVSH, zhvilluar në datën

23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.

II.2. Në datë 23.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 27.10.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Rikon-AL” SHPK	3.110.000	lekë	kualifikuar
2. “Sinteza Co” SHPK	3.449.600	lekë	kualifikuar

II.6. Në datën 06.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në datën 09.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2023/3581 dhe me nr. protokollit 2771/2023, datë 09.11.2023, e operatorit ekonomik “Sinteza CO” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rikon AI” SHPK.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2771/2 date 09.11.2023 dhe nr.2771/7 prot. datë 15.12.2023.

II.9. Në datën 14.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2771/3 prot., operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK në cilësinë e subjektit të interesuar, ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.10.Me shkresën nr. 2771/4 prot, datë 06.12.2023, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime, Qarku Shkodër SH.A, duke kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: [...] *informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave,*

të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Sinteza Co” SHPK si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Me shkresën nr. 2335 prot., datë 12.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2771/8, datë 18.12.2023, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion lidhur me procedurën e prokurimit.

II.11. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pezulluar procedurën e prokurimit. Ndërsa sa i takon shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sinteza CO” SHPK, autoriteti kontraktor informon se: “ ... *Ju bëjmë me dije se ankesa nuk është shqyrtuar, për arsye të mungesës së personelit të specializuar. Bazuar në nenin 101 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “për rregullat e prokurimit publik” shqyrtimi i ankesave nuk duhet të bëhet nga personat që kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa, si dhe të paktën njëri nga anëtarët e ngarkuar për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë specialist i fushës”.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sinteza Co” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Rikon AL” SHPK me arsyetimin se: “[...] *Kërkohet rivlerësim i ofertës dhe skualifikim i operatorit ekonomik “Rikon AL” për arsye se nuk ka objekt të aktivitetit disa nga zërat e prokurimit [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentare të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; [...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik , konstatohet se operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK ka dorëzuar:

1. “Formularin e vetëdeklarimit”, ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” është deklaruar si vijon:



Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Vërtetuar me ekstraktin historik të shoqërisë nga QKB
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Vërtetuar me dëshminë e penaltetit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Agon MAKOLLI, Administrator, NID:1014595216 <u>N.T.SH "RIKON" person fizik Sami Makolli, Ortak i vetëm (RIKON SH.P.K) shoqëri e themeluar sipas legjislacionit kosovar, me numër unik identifikimi 811502542, https://arbkrks.gov.net/page.aspx?id=1,38,213486 , Ortak i vetëm i OE RIKON-AI shpk.</u>
nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për pronarin dhe administratorin
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Dëshmi Penalteti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Ekstrakt Historik i Shoqërisë, Vërtetim statusi aktiv
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

III.1.4. Në Nenin 77, pika 1 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.5. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë “Rikon AL” SHPK, KPP gjykon, se kriteri në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues, në përputhje me objektin e procedurës objekt - ankimi, është një kërkesë e cila bën pjesë te kriteret e përgjithshme të kualifikimit, ku referuar përcaktimeve në dokumentet e tenderit, këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK rezulton, se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ky i fundit ka deklaruar: “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme - vërtetuar me ekstraktin historik të shoqërisë nga QKB”.

Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Rikon AL” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton, se objekti i aktivitetit të shoqërisë “Rikon AL” SHPK është përcaktuar: “Import eksport dhe tregtim me

shumice dhe pakice i te gjitha pajisjeve te printimit, softëare dhe pajisjeve te teknologjise se informacionit. Import, eksport, blerje, shitje, projektim, shërbim, mirëmbajtje, instalim, konfigurim, konsulencë, me pakicë ose shumicë i mallrave Kompjuterike , shërbimeve IT ,Softëare, pajisje në fushën e radio-komunikimit,sisteme aksesi,dhe cdo pajisje me perdorim ne fushen IT. Dhenie me qera e pajisjeve te ndryshme ne fushen e printimit dhe ofrues i sherbimeve te printimit te menaxhuar. Konsulence dhe sherbime informatike te ndryshme. Shtypshkrime te te gjitha llojeve der ne lidhjen e tyre. Blerje, shitje te pasurise te luajtshme dhe te paluajtshme.” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku deklarohet, se *në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Rikon AL” SHPK, sipas Ekstraktit të Regjistrit Tregtar si më sipër cituar, rezulton, se përfshihet objekti i prokurimit.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sinteza Co” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Rikon AL” SHPK me arsyetimin se: *“Kompania "RIKON-AL", sipas objektit te aktivitetit te paraqitur ne Qendren Kombetare te Biznesit, rezulton se nuk ka ne objekt biznesi sherbime dhe tregtim te produkteve qe perputhen me zerat e prokurimit :*

<i>Nr Pershkrimi</i>	<i>Sasia</i>
<i>6 UPS 650Ë</i>	<i>19</i>
<i>10 Kamera dome vandal proof.</i>	<i>9</i>
<i>11 Projektor DLP me rezolucion ̄XGA 1</i>	
<i>12 Palmar IP67 android</i>	<i>12</i>

Bazuar ne kete fakt, linden dyshime te forta se Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk ka kapacitet teknik dhe eksperience ne ofrimin e produkteve apo sherbimeve te ngjashme dhe zgjidhja teknike eshte realizuar ne menyre joprofesionale.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7/2, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.2.1., “*Kapaciteti teknik*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.2.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të*

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ndërsa, në shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” është parashikuar si më poshtë:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit qe kerkohet:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Kompjuter Desktop Bazik	Copë	15
2	Kompjuter Desktop i avancuar	Copë	5
3	Monitor per Desktop Bazik	Copë	12
4	Monitor per Desktop i avancuar	Copë	4
5	AIO 24-inch	Copë	2
6	UPS 650Ë	Copë	19
7	Fotokopje Multifunkionale A3	Copë	3
8	Printer termik Usb 80 mm	Copë	15
9	Karte aksesit 125kHz	Copë	200
10	Kamera dome vandal proof.	Copë	9
11	Projektor DLP me rezolucion ̄XGA	Copë	1
12	Palmar IP67 android	Copë	12

Afatet e lëvrimit: 10 dite duke filluar nga data e lidhjes së kontratës

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

1. *Faturë elektronike nr.2450/2023, datë 07.08.2023 me vlerë 1.390.000 lekë pa TVSh, blerës Porti Detar Sarandë.*
 - *Vërtetim nr.603/1prot., datë 25.09.2023 “Vërtetim realizim kontrate”, lëshuar nga “Porti Detar” Sh.A.*
2. *Kontrata nr.362/14 prot., datë 19.07.2023, lidhur mes autoritetit kontraktor Avokati i Popullit dhe operatorit ekonomik “Rikon Al” SHPK, me objekt “Blerje kompjuter për institucionin për vitin 2023” dhe vlerë 1.390.000 lekë pa TVSh.*
 - *Faturë elektronike nr.2306/2023, datë 24.07.2023 me vlerë 1.390.000 lekë pa TVSh, blerës Avokati i Popullit.*
 - *Vërtetim realizimi nr.485 prot., datë 18.09.2023, lëshuar nga Avokati i Popullit.*

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.2.5. Neni 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor 26 përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme, ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë, për të fituar kontratën publike në vlerën 20% të fondit limit të kësaj kontrate, të realizuar gjatë gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 20% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, nga operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK, janë paraqitur kontrata furnizimi me mall si më poshtë:

-Faturë elektronike nr.2450/2023, datë 07.08.2023 me vlerë 1.390.000 lellë pa tvsh, blerës Porti Detar Sarandë,

-Vërtetim nr.603/1prot., datë 25.09.2023 “Vërtetim realizim kontrate”, lëshuar nga “Porti Detar” Sh.A për Kontrata nr.513 prot., datë 28.07.2023, lidhur mes autoritetit kontraktor porti Detar Sh.A. Sarandë dhe operatorit ekonomik “Rikon Al” SHPK, me objekt “Pajisje zyre dhe informatike” dhe vlerë 1.390.000 lekë pa TVSh, e cila është realizuar me sukses.

- Kontrata nr.362/14 prot., datë 19.07.2023, lidhur mes autoritetit kontraktor Avokati i Popullit dhe operatorit ekonomik “Rikon Al” SHPK, me objekt “Blerje kompjuter për institucionin për vitin 2023” dhe vlerë 1.390.000 lekë pa TVSh.

- Faturë elektronike nr.2306/2023, datë 24.07.2023 me vlerë 1.390.000 lellë pa tvsh, blerës Avokati i Popullit.

- Vërtetim realizimi nr.485 prot., datë 18.09.2023, lëshuar nga Avokati i Popullit për operatorin ekonomik “Rikon AL” SHPK, për kontratën nr.362/14, datë 19.07.02023, me objekt “Blerje kompjuter për institucionin për vitin 2023” vlerë 1.390.000 lekë pa TVSh, e cila është realizuar me sukses.

Nga verifikimi i furnizimeve të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet. se operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK. ka kryer furnizime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me elementin kohë, *Faturë elektronike nr.2306/2023, datë 24.07.2023*, (kontrata me *nr.362/14 prot., datë 19.07.2023, lidhur mes autoritetit kontraktor Avokati i Popullit dhe operatorit ekonomik “Rikon Al” SHPK, me objekt “Blerje kompjuter për institucionin për vitin 2023”*) dhe *fatura nr.2450/2023, datë 07.08.2023* janë brenda afatit kohor 3 vjeçar, nga momenti

i shpalljes së njoftimit të kontratës së procedurës objekt – ankimi, e cila është publikuar më datë 10.10.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në lidhje me elementin vlerë, për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të fondit limit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera e realizuar me autoritetin kontraktor Avokati i Popullit dhe Portin Detar Sh.A është 2.780.000 lekë pa TVSH, duke e tejkaluar vlerën e kërkuar sipas kriterit 2.2.1 të dokumenteve standarde të tenderit. Në lidhje me elementin natyrë e ngjashme, dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi kontrata e mësipërme është kontratë malli dhe është kontratë e ngjashme, pasi kemi të bëjmë me artikuj pajisje elektronike, në përputhje me kriterin e parashikuar në dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas përmbajtjes së nenit 40 "Kërkesat e veçanta të kontratave të mallrave", në pikën 4, ku ndër të tjera parashikohet: *"4. Për të provuar përvojën e mëparshme...Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."* Siç shihet nga kjo dispozitë për të vërtetuar përvojën e ngjashme autoriteti kontraktor ka kërkuar këto dokumente; a) Nga entet publike; Vërtetim nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës së furnizimit ose/dhe fatura tatimore shitje për sasi të mallrave të furnizuara b) Nga sektori privat: - Fatura tatimore të shitjes. Nga ana e ankimuesit janë dorëzuar, fatura tatimore të shitjes (kontratë furnizimi malli), si dhe vërtetim realizim kontrate me një ent publik, duke shënuar, kohën, vlerën dhe realizimin me sukses të kësaj kontrate. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "Rikon AL" SHPK vërteton, se ka kryer furnizime të ngjashme me zërat e parashikuar për kontratën objekt - shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sinteza Co" SHPK, për mospërmbushjen nga operatori ekonomik "Rikon AL" SHPK të kriterëve 2.2.3 dhe 2.2.4 në kriteret e veçanta për kualifikim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këtë pretendim, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e kriterëve 2.2.3 dhe 2.2.4 në kriteret e veçanta për kualifikim.

III. 3.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të

ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.3.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Rikon AL” SHPK të kriterëve 2.2.3 dhe 2.2.4 në kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht për katalogët dhe autorizim prodhuesi të parashtruara në ankesë, ankimesi “Sinteza CO” SHPK duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor nga njëra anë, dhe pretendimit/pretendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori, duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështeten pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij, se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se *“onus probandi incumbit actori”*, se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.3.6. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik *“Sinteza Co”*, për mospërbushjen nga operatori ekonomik *“Rikon AL”* SHPK të kriterëve 2.2.3 dhe 2.2.4 në kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht për katalogët dhe autorizim prodhuesi të parashtruara në ankesë, nuk merret në shqyrtim.

III.4. Sa i përket pretendimit të operatorit ankimues për ekspertizë të posaçme të specifikimeve teknike të formularit të ofertës teknike të dorëzuar nga operatori ekonomik *“Rikon AL”* SHPK me specifikimet teknike të DST, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk merret në shqyrtim, pasi nuk evidentohet se për çfarë kërkohet ekspertiza. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm qartë pretendimin e tij edhe lidhur me ekspertizën e kërkuar. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të

ankimuesit dhe respektimit të afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Sinteza CO” SHPK për ekspertizë të posaçme, është një pretendim, i cili nuk merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sinteza CO” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82700-10-09-2023, me objekt: “Blerje materiale kompjuterike”, me fond limit 3,477,567 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sinteza CO” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

